



**KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR**  
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ  
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

Numër: 111-01/25  
Data: 07.04.2025  
Bujanoc

Në bazë Nenit 113 paragrafi 2 pika 1 të Ligjit për Këshillat Kombëtare të Pakicave Kombëtare (Fletorja zyrtare R.S. 72/2009,20/2014 - vendimi i GJK 55/2014 dhe 47/2018) dhe neni 14, paragrafi 1, pika 3 dhe 20 e Statutit të Këshillit të Kombëtar Shqiptar nr.284-01/23 të datës 06.07.2023, si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar Shqiptar nr. 111-01/25, datë 07.04.2025, shpallim:

### **THIRRJE PËR BURSA STUDENTORE**

**Ftohen të gjithë studentët shqiptarë që jetojnë në Luginën e Preshevës dhe Sanxhak, të aplikojnë për bursa studentore që Këshilli Kombëtar Shqiptar ndan në zbatim të ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e RKS për vitin 2025, nga organizata buxhetore "Zyra e Kryeministrit", nën-programi "Përkrahje për Luginën e Preshevës dhe Sanxhakun" me kod 39100, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".**

Për bursa studentore, do të përfshihen studentët e të niveleve Bachelor dhe Master. Shuma e granteve për të dyja nivelet do të caktohet nga Këshilli Kombëtar Shqiptar.

Kriteret e përzgjedhjes për nivelin Bachelor:

1. Përfshirja e të gjithë studentëve të rregullt;
2. Studentët e nivelit Bachelor deri në moshën 26 vjeç;

Kriteret e përzgjedhjes për nivelin Master:

1. Përfshirja e të gjithë studentëve;
2. Studentët e nivelit Master deri në moshën 28 vjeç;
3. Studentët e nivelit Master nuk duhet të jenë në marrëdhënie pune.

Aplikacionet duhet të dorëzohen fizikisht në ambientet e selisë së Këshillit Kombëtar Shqiptar, në Rr. Karagjorgje Petroviq nr.237, Bujanoc dhe **zyrat e Këshillit Kombëtar Shqiptar, në Preshevë, Rr, 15 Nëntori nr.90 (objekti i Shtëpisë së Kulturës), Zyra e Këshillit Kombëtar Shqiptar në Medvegjë, Rr. Vojvode Mishiqa 6 si dhe në zyren e Këshillit Kombëtar Shqiptar në Novi Pazar, Rr. Shabana Koce nr.13 më së voni ora 15:00, datë 23.04.2025.**

Format për aplikim si dhe të gjitha informatat tjera gjinden në [www.kksh.org](http://www.kksh.org) (website i KKSH-së). Për informata shtesë ju lutem na shkruani në [kksh.grantet@gmail.com](mailto:kksh.grantet@gmail.com) ose na telefononi në nr. **00 381 17 853 264.**

**Vërejtje:** Vetëm aplikimet e dorëzuara brenda afatit dhe me dosje të plotë do të shqyrtohen.

Për aplikuesit nga Sanxhaku, dëshmi shtesë duhet të dorëzohet VËRTETIMI (i cili duhet të jetë jo më i vjetër se një ditë para datës së shpalljes së Thirrjes, gjegjësisht deri më 07.04.2025) se është i regjistruar në listën e veçantë zgjedhore si SHQIPTAR!